

Statistikat e Transportit Ajror

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Kërkim-Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Albana Osmenaj
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	aosmenaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	29.10.2024
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	29.10.2024
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	29.10.2024
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat e Transportit Ajror përfshijnë informacion mbi flukset e mallrave, numrit të pasagjerëve si edhe treguesit specifik të transportit ajror. Këto statistika përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëvizjen e numrit të pasagjerëve; • Volumin e mallrave; • Treguesit specifikë për transportin ajror; • Volumin e eksport/importeve të mallrave të transportit ajror.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet.

3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhënat për Transportin Ajror të kryer në Republikën e Shqipërisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><u>Transport Ajror</u></p> <p>Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve në lëvizjen e avionëve.</p> <p>Aeroport - Një zonë e caktuar e tokës ose ujit (përfshirë ndërtesat, instalimet dhe pajisjet) të destinuara për t'u përdorur goftë tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionëve dhe të hapur për operacionet tregtare të transportit ajror.</p> <p>Linjë ajrore - Një ndërmarrje aviacioni që operon aeroplanët për qëllime tregtare që (i) kryen shërbime të planifikuara të transportit ajror, ose të dy, të cilat janë në dispozicion të publikut për transportin e pasagjerëve, postën, dhe / ose ngarkesa dhe (ii) është vërtetuar për qëllime të tilla nga autoriteti i aviacionit civil të shtetit në të cilin është themeluar.</p> <p>Shërbimi ajror i pasagjerëve - Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar i kryer nga aeroplanët që transportojnë një ose më shumë pasagjerë të ardhura dhe çdo fluturim të listuar në oraret e publikuara si të hapura për pasagjerë.</p> <p>Shërbimi ajror i mallrave dhe i postës - Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar, i kryer nga aeroplanët që mbajnë ngarkesa të ardhura (mallrave dhe postës), përveç pasagjerëve.</p> <p>Numri i fluturimeve - Është numri i parë fillestar i publikuar i caktuar nga operatori i transportit ajror në fluturim. Pasagjerët që përdorin një fluturim nga një aeroplan mund të udhëtojnë nën një sërë numrash të ndryshëm fluturimesh.</p> <p>Pasagjerë të transportuar - Do të quhen të gjithë pasagjerët udhëtimi i të cilëve fillon ose mbaron në aeroportin raportues.</p> <p>Mallrat e transportuar - Përfshijnë çdo ngarkesë e ngarkuar në avion ose e shkarkuar prej tij, duke përfshirë bagazhet e pasagjerëve dhe postën.</p> <p>Eksportet/importet e mallrave</p> <p>Eksportet - Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.</p> <p>Importet - Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Njësitë statistikore sipas llojeve të transportit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aeroportet kombëtare në vend për të dhënat e transportit ajror. • Ndërmarrjet eksportuese/importuese të cilat kryejnë aktivitet në transportin ajror.

3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin numrin e pasagjerëve (shqiptarë dhe të huaj) si dhe volumin e mallrave (të hyrë dhe të dalë).
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e Statistikave të Transportit Ajror mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Statistikat e Transportit Ajror datojnë nga viti 1993.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Të dhënat mbi Statistikat e Transportit Ajror publikohen vetëm në vlera absolute dhe përqindje. Njësia matëse për pasagjerët është numri i pasagjerëve dhe pasagjerë të hyrë e të dalë, ndërsa për mallrat është ton për ngarkim/shkarkimin e mallrave dhe postës.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi Statistikat e Transportit Ajror është tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e indikatorëve për Statistikat e Transportit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Vendimet e Këshillit të Statistikave. <p>Sipas rregulloreve përkatëse të BE-së janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 437/2003, datë 27 Shkurt 2003 “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin ajror të udhëtarëve, mallrave dhe postës”.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Transportit Ajror nuk transmetohen në Eurostat. Aktualisht, INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me Statistikat e Transportit Ajror, të tilla si: Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Federata Ndërkombëtare e Rrugëve (IRF), Common Questionnaire, etj.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i Ligjit Nr 17/2018, "Për

	<p>Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave.</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit, në fund të vitit paraardhës. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<p>Kalendari i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.</p>
8.3. Aksesin i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e</p>

	<p>mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individi për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – press release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi “Statistikat e Transportit Ajror” 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Statistikat e Transportit Ajror shpërndahen në baza tremujore dhe vjetore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të statistikave të transportit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Volumi i mallrave të transportuar me ajër; • Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër; • Treguesit specifike të transportit ajror; • Volumi i eksport/importeve të mallrave me ajër. <p>Njoftimi për shtyp për Statistikat e Transportit Ajror publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	<p>Statistikat e Transportit Ajror gjenden të botuara në botimin “Statistikat e Transportit Ajror” dhe në botimin “Shqipëria në Shifra”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statistikat e Transportit Ajror • Shqipëria në Shifra
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi Statistikat e Transportit Ajror publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin: Databaza
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia është e bazuar në manualët dhe rregulloret e Eurostat mbi Statistikat e Transportit, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh

	mbi plotësimin e treguesve për llojet e ndryshme të transportit. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë e përdorur mbi Statistikat e Transportit.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ndjekura lidhur me statistikave të transportit ajror për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT, për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e Transportit Ajror krahasohen me të dhënat e Transportit Ajror një vit më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e të dhënave të transportit janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike; • Universitete; • Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Biznese; • Kërkues shkencorë, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT analizon çdo vit klikimet e faqes web dhe klikimet në lidhje me temën “Statistikat e Transportit” për vitin 2023 janë 12,133. INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për matjen e Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve . Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme mbi “Statistikat e Transportit” është vlerësuar me 3,97 (79.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).

12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të Transportit Ajror për vitin 2024 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT nga ato të kërkuara nga rregulloret e ndjekura.</p> <p>Shkalla e plotshmërisë së të dhënave në lidhje me Statistikat e Transportit Ajror, është afërsisht 40%.</p>								
13. Saktësia dhe besueshmëria									
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Të dhënat mbi Transportin Ajror mblidhen në mënyrë administrative në zbatim të bazës ligjore dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit. Nuk kryhen vrojtime për të dhënat e Transportit Ajror. Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.</p>								
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet pasi të dhënat janë administrative.</p>								
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.</p>								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Statistikave të Transportit Ajror janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 29 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+29 ditë).</p> <table border="1" data-bbox="555 1402 1070 1529"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/29/2024</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>29</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2024	Data e publikimit	10/29/2024	Afatet kohore	29		
Periudha referuese	9/30/2024								
Data e publikimit	10/29/2024								
Afatet kohore	29								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për Statistikat e Transportit Ajror publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Transportit ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="555 1686 1070 1832"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>10/29/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/29/2024</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2024	Data e shpallur	10/29/2024	Data e publikimit	10/29/2024	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	9/30/2024								
Data e shpallur	10/29/2024								
Data e publikimit	10/29/2024								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat që INSTAT prodhon janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat. Statistikat e Transportit Ajror prodhohen në nivel vendi.</p>								

15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Informacioni statistikor i Transportit Ajror grumbullohej në mënyrë tremujore duke filluar nga viti 1993 deri në 2016. Nga viti 2016-2022 të dhënat janë publikuar çdo muaj, duke siguruar një krahasueshmeri kohore prej 7 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=7).</p> <p>Nga viti 2023 e në vazhdim të dhënat filluan të publikohen çdo tremujor.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Përpara finalizimit të të dhënave, kontrollohet konsistenca e brendshme e tyre. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca e tyre në seri të ndryshme.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të transportit pranë Sektorit të Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të statistikave të transportit hartohen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë, referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se autoritetet lokale do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara pranë INSTAT, informacioni përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikat e Transportit Ajror” për vitin 2024, subjekt i këtij raporti.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i vetëm i të dhënave të Transportit Ajror është burimi administrativ. Të dhënat grumbullohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Mbulimi është në nivel vendi, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mbi Statistikat e Transportit Ajror grumbullohen në baza mujore.

18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e Transportit Ajror janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor grumbullohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe detajohet sipas transportit të mallrave dhe postës, pasagjerëve (të hyrë e të dalë) si dhe eksport/importit të mallrave, me frekuencë mujore.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave të Statistikave të Transportit Ajror ju kryhen kontrole logjike dhe matematike. Këto kontrole realizohen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komete	
Aneks	